**VENDIM**
**Nr.1685, datë 24.12.2008**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.906, DATË 19.2.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA, PËR SHËRBIMIN KOMBËTAR TË PUNËSIMIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001"Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.906, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave, shtohet prona "Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik, Gjirokastër", sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror Ministria e Punë, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Shërbimi Kombëtar i Punësimit
Bashkia Gjirokastër
Fusha e përdorimit të pronës: Drejtori Rajonale e Formimit profesional Publik, Gjirokastër

| Nr rend. | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona kadastrale dhe indeksi i hartës | Nr.pasurisë | Lloji i pronës | Emri i pronës Adresa | Sip.totale e pronës $m^2$ | Nga sip.totale sa ndërtesë $m^2$ | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni/ Enti përgjegjës administrativ | Institucioni/ Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (shënime të veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| | | | Administrative | Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik (ish Turizmi i ri Gjirokastër) | 8000 | 425 | Drejtori Rajonale e Formimit Profesional Publik | MPÇSSHB | SHKP/DRFPP Gjirokastër | Ambientet ndodhen në ndërtesën e ish-Turizmit të ri, Gjirokastër dhe kanë kaluar në pronësi të MPÇSSHB me urdhër të përbashkët të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me nr.1, datë 26.12.2006, dhe urdhrit nr.100, dt.13.12.2007 të Ministrisë Ekonomisë, Tregtisë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | dhe Energjetikës |